



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 350 Prot.
11

Tiranë, 15/7 2024

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Z. Fatmir Xhafaj
Kryetar i Komisionit të Posaçëm Parlamentar

Kuvendi i Shqipërisë
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
TIRANË

I nderuar z. Xhafaj,

Në vijim të ftesës për bashkëpunim drejtuar Avokatit të Popullit, për të qenë pjesë e procesit dhe për të mbështetur punën e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian, kemi kënaqësinë tju konfirmojmë gadishmërinë dhe angazhimin për të jetësuar realizimin e këtyre objektivave.

Avokati i Popullit nisur nga mandati dhe misioni i tij kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, luan një rol thelbësor në promovimin e një shoqërie të drejtë, të barabartë dhe të lirë për të gjithë. Mirëqeverisja, sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut janë dimension thelbësor dhe i pandashëm i një shoqërie të drejtë dhe të qëndrueshme. Nga ana tjetër vlerësojmë se trajtimi i kritikës konstruktive përbën element të rëndësishëm të shtetit të së drejtës.

Sa më sipër, duam të shprehim dakortësinë tonë për të kontribuar me ekspertizë në fushat që lidhen me mirëqeverisjen dhe sundimin e ligjit, nëpërmjet propozimit të ekspertëve si më poshtë:

Për Grupet e Ekspertëve:

- a. Znj. Vilma Shurdha – Komisioner; dhe
- b. Znj. Olta Aliaj - Komisioner

Për Sekretariatit Teknik:

- a. Alket Jaupi - Ndhmëskomisioner; dhe*
- b. Kejsi Rizo - Ndhmëskomisioner*

Në ndërkohë, Avokatja e Popullit do të jetë e pranishme në mbledhjet e komisionit rast pas rasti sipas vlerësimit tuaj e në përputhje me detyrimet e tjera institucionale. Po ashtu do të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm përmes vënies në dispozicion të çdo kontributi apo dokumenti të hartuar nga Avokati i Popullit për fushat që lidhen me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe besimin e treguar.

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca
ERINDA BALLANCA

